

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.07.2023*

07.05.2023
Ora 12:07

RENDI I DITËS

Shortit “Për caktimin e relatorëve të kërkesave nr. 19, 20, 21, 22, 23 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ”.

PJESËMARRJA :

- Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, Znj. I. Osmanaj.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve! Sot, në datën 07.05.2023 ora 12:07, hidhet procedura e shortit për caktimin e relatorit, për kërkesat e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ. Kërkesat me nr. 19, 20, 21, 22 dhe 23. Procedura e shortit është parashikuar në nenin 14 të rregullores së KAS-it. Referuar dhe nenit 35 të rregullores së KAS-it, Komisionerit i njihet e drejta për të paraqitur kërkesë për vendosje sanksioni administrativ. Për këtë kemi përgatitur 5 shirita letre ku janë shënuar 5 kërkesat e Komisionerit, të cilat palosen dhe vendosen në 5 gogla me peshë, ngjyrë dhe formë të njëjtë, në një enë transparente. Duke qenë se anëtarët e KAS-it nuk janë prezent, kanë autorizuar një përfaqësues të KQZ-së për të tërhequr goglat në emër dhe për llogari të tyre duke filluar nga rendi alfabetik rritës.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvin Lako – Kërkesa e Komisionerit me numër 19.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Elvis Çefa - Kërkesa e Komisionerit me numër 21.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ilirjan Rusmali - Kërkesa e Komisionerit me numër 23.

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.07.2023*

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Koli Bele - Kërkesa e Komisionerit me numër 22.

Tërhiqet gogla në emër dhe për llogari të zotit Ledio Braho - Kërkesa e Komisionerit me numër 20.

Në përfundim të procedurës së shortit, relatorët e kërkesave të komisionerit për vendosje sanksioni administrativ janë caktuar si më poshtë:

Zoti Elvin Lako – Relator i kërkesës së Komisionerit me numër 19

Zoti Elvis Çefa – Relator i kërkesës së Komisionerit me numër 21

Zoti Ilirjan Rusmali - Relator i kërkesës së Komisionerit me numër 23

Zoti Koli Bele – Relator i kërkesës së Komisionerit me numër 22

Zoti Ledio Braho – Relator i kërkesës së Komisionerit me numër 20

Ju faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Arlinda BAHOLLARI*

